

VENDIM
Nr. 53, datë 5.12.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E
RAJONEVE NR. 9, DATË 10.3.2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 15, të aneksit 3, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën nr.2, që i bashkëlidhë vendimit nr. 9, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për miratimin e financimit për vitin 2016, për disa projekte në vazhdim të grantit “Infrastruktura vendore dhe rajonale”, programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, shtylla I”, bëhen ndryshimet, sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Zhvillimit Urban dhe ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Niko Peleshi

Zëvendëskryeministri	Zëvendëskryetar,
Ministri i Financave	anëtar,
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit,	
Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
Ministri i Zhvillimit Urban	anëtar,
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar,
Ministri i Arsimit dhe Sportit	anëtar,
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe	
Administrimit të Ujërave	anëtar,
Ministri i Shëndetësisë	anëtar,
Ministri i Kulturës	anëtar,
Ministri i Mjedisit	anëtar,
Ministri i Punëve të Brendshme	anëtar,
Ministri i Shtetit për Inovacionin	
dhe Administratën Publike	anëtar,
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Qirqeve të Shqipërisë	anëtar,
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 1	anëtar,
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore /	
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 2	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 3	anëtar,
Përfaqësuesi i Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal nr. 4	anëtar.

Tabela 1. Ndryshim në vendimin nr.9, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projekteve nr.6 dhe 78, si më poshtë vijnë, në tabelën 2, të këtij vendimi i bëhen ndryshimet, në kolonën "Vlera e kontratës" dhe "Vlera e financimit për vitin 2016", si më poshtë vijnë:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vendimi i KZHR-së	Vlera e projektit (Lekë)	Vlera e kontratës (Lekë) / veprimi korrigjues (*)	Vlera e financimit për vitin 2015 (Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (Lekë)	
							Ishte	Bëhet
6	Bashkia Bulqizë	Pedonale, lagja Minatori, Faza 2	Nr.39 datë 16.10.2015, Nr. 9, datë 10.3.2016	48 642 308	47 221 645	4 864 231	34 487 140	42 357 414
78	Bashkia Konispol	Rikonstruksioni i sheshit qendror të qytetit	Nr.39 datë 16.10.2015, nr.9, datë 10.3.2016	54 594 958	52 513 356	5 459 496	38 305 234	47 053 860
TOTAL				103 237 266	99 735 001	10 323 727	72 792 374	89 411 274

Shënim:

1. Veprimi korrigjues i vlerës së kontratës bëhet pasi vlera e deklaruar më parë nga autoriteti kontraktues si vlerë e kontratës, nuk përfshinte vlerën e TVSH-së. Kjo vlerë e ndryshuar nuk e kalon vlerën e plotë të projektit, të miratuar më vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve. Korrektimi i vlerës së kontratës në këtë tabelë bëhet me kërkesë të sekretariatit teknik pranë ministrisë së Zhvillimit Urban, nr.5127/1, datë 27.9.2016.
2. Totali i vlerës së kontratës për tabelën 1 që i bashkëlidhet vendimit nr.11, datë 10.3.2016, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, bëhet si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Vlera e kontratës (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)	Vlera e financimit për vitin 2016 (në lekë)
TOTALI			7 525 135 331	6 570 468 974	4 863 746 364	1 706 722 607

